



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarive Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.3.2021, ora 12:06

Drejton mbledhjen:

Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi dhe miratimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së madhe dhe Irlandës së Veriut". (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ilir Beqaj, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Eglantina Gjermani, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Klajdi Qama, Kujtim Gjuzi, Halit Valteri, Tatiana Nurçe Piro, Zef Shtjefni dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Ardit Konomi, Rrahman Rraja dhe Dritan Bici.

Të ftuar:

Milva Ikonomi – Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Besart Kadia - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Joniada Barjaba – Drejtor i Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Agron Tare - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Ilir Beqaj - Mirëdita kolege dhe kolegë deputetë!

Fillojmë mbledhjen e sotme të komisionit, datë 5.03.2021, ora 12:06. Siç jeni njoftuar, sot në rendin e ditës kemi diskutimin dhe miratimin e marrëveshjes që ju ka ardhur me *email*, për të cilën jemi komision përgjegjës. Për këtë marrëveshje edhe komisionet e tjera i kanë dhënë mendimin e tyre. Kështu që, unë mendoj t'ua japim fjalën përfaqësuesve të qeverisë, që do të prezantojnë nismën.

Agron Tare - Ky projektligj, siç jeni në dijeni, ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjeve nga Kuvendi midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

Ky projektligj është miratuar në parim në Këshill të Ministrave më 16 dhjetor të vitit të kaluar dhe është nënshkruar nga palët më 15 shkurt të këtij viti.

Siç jeni në dijeni, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis vendeve të BE-së dhe Shqipërisë, e cila është firmosur në qershor të vitit 2006 në Luksemburg, nuk është më e vlefshme për Britaninë e Madhe, pas daljes së saj nga BE-ja më 31 dhjetor. Pra, për të adresuar këtë situatë specifike lindi nevoja e kësaj marrëveshjeje. Në këndvështrimin e Ministrisë së Jashtme është një marrëveshje shumë e rëndësishme, pasi Britania e Madhe është një vend kyç për interesat tona.

Për pjesën teknike do të flasë zëvendësministri tjetër.

Besard Kadia - Me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje të ardhurat nga tregtia me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria do të kenë përfitim reciprok të njëjtë që kanë përfituar kur Mbretëria e Bashkuar ka qenë pjesë e komunitetit evropian. Marrëveshja synon bashkëpunimin dhe vazhdimin ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Është një marrëveshje, e cila parashikon rregullimin e dispozitave të marrëveshjes së MSA-së. Ajo synon të vazhdojë të rrisë me tej shkëmbimet tregtare midis Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Vitet e fundit shkëmbimet në një lidhje tregtare jo shumë të lartë krahasuar me vendet e tjera të BE-së, por, gjithsesi, duke parë edhe synimin që ka Mbretëria e Bashkuar për të vazhduar marrëdhëniet me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor

Besoj se u dëgjova?!

Illir Beqaj - Zoti Kadia, dëgjoheni?

Ky ishte prezantimi juaj?

Faleminderit!

Ka përfaqësues tjetër nga qeveria?

Fjala për ministren e Bujqësisë.

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

Vij si ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sepse ne kemi një pjesë të rëndësishme në këtë marrëveshje. Ajo që doja të sillja si risi është që kjo marrëveshje, që miraton Kuvendi i Shqipërisë midis Britanisë dhe Irlandës së Veriut, është një marrëveshje që rrjedh nga marrëveshja e MSA-së dhe si e tillë, në konsideratën tonë, është e rëndësishme, sepse marrëdhëniet tregtare me BE-në nuk ndryshojnë kuota dhe shtohen kuota të reja me një koeficient, i cili është negociuar nga Ministria e Financave. Ne shtojmë sasinë e produkteve bujqësore dhe blegtorale, që është tani tregu i BE-së plus Britaninë e Madhe dhe Irlandën.

Për këtë arsye për Ministrinë e Bujqësisë kjo marrëveshje merr një rëndësi të veçantë, kështu që edhe angazhimi ynë për t'iu përgjigjur në kohë të gjitha kërkesave që kishte si Ministria e Financave, si Ministria e Punëve të Jashtme ka qenë maksimal, në mënyrë që kuotat të ishin të mirëkorduara në çdo moment.

Faleminderit!

Illir Beqaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Ndjesë që jua dhashë fjalën të tretës, por nuk e dija që ishit prezent!

Fjala për relatoren, zonjën Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Zëvendësministra,

Siç u tha, qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi nga Kuvendi i marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda e Veriut kanë qenë palë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-Bashkimi Europian. Për këtë arsye, mallrat me origjinë britanike kanë qenë pjesë e trajtimeve preferenciale në kuadër të MSA-së.

Meqenëse Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda e Veriut nuk janë më palë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-Bashkimi Europian, dhe më 1 janar 2021, ku përfundon edhe periudha tranzitore pa një marrëveshje të re mes Shqipërisë dhe këtyre dy vendeve, mallrat me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga Shqipëria nuk do të përfitojnë më trajtim tarifor preferencial reciprok që kishin deri në këtë datë si palë e MSA-së.

Konkretisht, kjo marrëveshje synon ruajtjen e marrëdhënieve ndërmjet palëve, të krijuara nga lidhja e përcaktuar në nenin 1 të marrëveshjes Shqipëri-Bashkimi Europian, sigurimin e vijimit të bashkëpunimit dhe vazhdimin e tregtisë ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar me të njëjtat kushte preferenciale edhe pas daljes nga Bashkimi Europian, si dhe rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar ndërmjet dy shteteve tona, duke ndikuar ndjeshëm në nivelin e flukseve të investimeve të huaja direkt në Shqipëri në rritjen e eksporteve shqiptare, si dhe në përmirësimin e ndjeshëm të bilancit tregtar të vendit.

Sipas të dhënave ekzistuese, ka ende një potencial të pashfrytëzuar të rritjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy shteteve tona, prandaj për këtë qëllim ratifikimi dhe hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje do të nxisë më tej bashkëpunimin ekonomik ndërmjet dy vendeve dhe do të ndikojë ndjeshëm në nivelin e flukseve të investimeve të huaja.

Meqenëse jemi relativisht pak vonë në ratifikimin e kësaj marrëveshjeje dhe, duke qenë se hyrja në fuqi e saj sa më shpejt ndikon dhe e nxit më mirë këtë shkëmbim ekonomik mes shteteve tona, i ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë, duke kaluar direkt në votim.

Faleminderit!

Ilir Beqaj – Faleminderit, zonja Gjermani!

A ka ndonjë nga kolegët diçka për të shtuar? Nuk ka.

Hedhim në votim miratimin në parim të ligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”.

Kush është dakord në parim?

Halit Valteri – Kryetar, jam dakord, por nuk kam video.

Ilir Beqaj – Faleminderit, zoti Valteri!

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit? Kundër?

Kujtim Gjuzi – Kryetar, kam diçka për procedurë, sa i takon abstenimit.

Ilir Beqaj – Jemi në votim.

Kujtim Gjuzi – E di që jemi në votim, po keni kaluar procedurën.

Ilir Beqaj – Jo, nuk kam kaluar asnjë procedurë.

Kujtim Gjuzi – Kur thatë pro, kundër, abstenimin e kaluat përnjëherë pa marrë abstenimin e Gjuzit.

Ilir Beqaj – Ju nuk e shprehët abstenimin, por mund ta shprehni tani.

Kujtim Gjuzi – Unë nuk dua të bëj zhurmë.

Ilir Beqaj – Në rregull. 1 abstenim, zoti Gjuzi.

Miratohet.

Projektligji miratohet.

Ju falënderoj kolegë dhe punë të mbarë!

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA